



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALISHEVO



Kuvendi i Komunës
Nr. 02/____
Datë: 30.12.2024

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

My Mrs. Dr.

10.01.2025

02/489

Në bazë të nenit 8, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 16, nenit 17 shkronja (k.s), nenit 24, nenit 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), bazuar në nenin 2 paragrafi 2.3, të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/03 qershor 2008"), në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 1 shkronja (b), nenit 40, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441, datë:14.09.2023, kërkesën nr.01/942, datë, 12.08.2024, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur me dat, 30.12.2024, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR NGRITJEN E SHTATORËS SË DËSHMORIT
"TAHIR SINANI"

1. Miratohet kërkesa nr.01/942, dt.12.08.2024, të parashtruar nga kryetari i komunës për përkrahejn e kërkesës nr.01/781, dt.26.06.2024, të grupit të vullnetarëve për realizimin e projektit për ngritjen e Shtatorës së Dëshmorit "Tahir Sinani" në Qytetin e Prizrenit, në shumën prej 10,000.00 €.
2. Mjetet ndahen në emër të participimit në ngritjen e Shtatorës të cekur sipas nenit 1 të këtij Vendimi, ndërsa mjetet do të ndahen nga kategoria e subvencioneve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomik, Financa dhe Buxhet.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorive të KK-së.

